



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.16, datë 23.10.2019

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT TË OBJEKTIT:
“VEPËR INDUSTRIALE MAGAZINË”, ME VENDNDODHJE NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE KASHAR, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 17, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Marketing & Distribution” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit të objektit: “Vepër industriale magazinë”, me vendndodhje në Njësinë Administrative Kashar, Bashkia Tiranë, me zhvillues “Marketing & Distribution” sh.p.k, miratuar me Vendimin Nr.14, datë 28.07.2016 të Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.14, datë 28.07.2016, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
- 4.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INERASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

